

Informacioni i standardizuar parakontraktor i kredisë konsumatore.

Kujdes! Marrja e nje kredie mbart kosto!

Nënshkrimi i këtij dokumenti nga ana juaj përbën marrje dijeni të informacionit parakontraktor, por nuk detyron ECFA Sh.a të miratojë kërkesën tuaj për kredi apo të lidhë kontratë me ju.

1. Emri dhe detajet e kontaktit të institucionit kredidhënës

Kredidhënësi	ECFA Sh.a
Adresa	Rruga "Muhamet Gjollësja", Ndertesa Tirana Ring Center, Nr. 8, Kati i 9-te, Tirane, Albania
Numri i Telefonit	+355 44 500 600
Adresa e postës elektronike	info@kredo.al
Adresa e Web-it	www.kredo.al
Vendi i ofrimit	

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji i kredisë	Kredi konsumatore me këste. Ne perputhje me nenin 44 pika 3 te LIGJIN NR.9902, DATË 17.4.2008 "PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE" te ndryshuar: Kredi konsumatore perkufizohen vlerat që përfaqësojnë një shumë totale të kredisë më tepër se 30 mijë lekë ose më pak se 10 milionë lekë.
Vlera totale e kredisë dhe monedha. (Nënkupton kufirin maksimal ose shumën totale të disponueshme, të kredisë)	Monedha*: ALL Shuma: 63000.00 ALL
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve. (Nënkupton si dhe kur do merren paratë)	Pas lidhjes së një marrëveshje kredie, kredia e dhënë kreditohet në llogarinë bankare të klientit brenda 3 ditëve të punës. Klienti ka të drejtë të zgjedhë një lloj tjetër të dhënies së kredisë (Western Union, Easy Pay, ose me para në dorë në një nga degët e ECFA Sh.a), por në këtë rast, komisionet mund të aplikohen në përputhje me listën aktuale të çmimeve në ECFA Sh.a.
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	Kontrata e linjës së kredisë lidhet për një afat të pacaktuar dhe mund të zgjidhet në përputhje me kushtet e saj. Kohëzgjatja e kredisë: 18 muaj
Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet.	Çdo datë: 11.08.2025 të muajit Frekuencë mujore përgjatë: 18 muajve Vlerë Kësti për t'u paguar: 4700.00 ALL <i>Në vlerën e këstit, përfshihet shlyerja e principalit, interesit.</i> Këstet do të paguheshin në monedhën e kredisë, në një prej degëve të ECFA Sh.a, apo në një nga pikat e Western Union, Easy Pay, ose në çdo llogari bankare të ECFA Sh.a: BKT BANK: AL37 2051 1227 0033 69 CLPRCLALLA Raiffeisen Bank: AL13 2021 1130 0000 0000 2132 6338 Credins Bank: AL40 2121 1212 0000 0000 0100 2347 Intesa San Paolo Bank: AL13 2081 1008 0000 0209 5473 5301 Union Bank: AL49 2141 1182 0198 5781 5672 0113 Tirana Bank: AL77 2061 1042 0000 1403 2291 4101 OTP Albania Bank: AL30902117974551240020156176
Shuma totale që kredimarrësi do të ketë për të paguar.	88390.00 ALL
Kostoja e kredisë është llogaritur sipas komisioneve në fuqi në datën e pranimit të këtij dokumenti.	Kjo vlerë përbëhet nga: Principal 63000.00 ALL
Kostot/komisionet e kredidhënësit mund të ndryshojnë në të ardhmen, sipas kushteve të kontratës së kredisë.	Interes 21610.00 ALL Komision Angazhimi: 3780.00 ALL

3. Kostoja e kredisë

Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në marrëveshjen e kredisë.	Normë fikse mujore e interesit për kredinë në masën 3.30% .
Norma efektive e interesit (NEI)% <i>Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr. 1 të rregullores nr. 59 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.</i>	61.13% Norma efektive e interesit ka të përcaktuar një normë maksimale sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, e publikuar në faqen zyrtare të saj. Aktualisht maksimumi i NEI i aplikuar në këtë kredi është maksimumi i nivelit: Për segmentin nga 0 – 200,000 ALL maksimum prej 62.20% <i>Shembull:</i> <i>Kredi me vlerë 63000.00 ALL. Supozojmë që kredia mbahet për afatin e aprovuar 18 muaj dhe paguhet cdo muaj deri në afatin e maturimit. Në këtë mënyrë, klienti paguan 18 këste deri në maturim.</i> <i>Në formulën më poshtë “i” është NEI 63000.00 = 4700.00 ALL/((1+i)^(30/365)) + ... (18 herë).</i> <i>Prandaj NEI shprehet në përqindje - 61.13.</i>
A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar kontratat e sigurimit për kredinë?	Jo.
Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.	Komision angazhimi, ALL: 3780.00 ALL Ky komision përlllogarit mbi vlerën e kredisë së lëvruar dhe është i pagueshëm në momentin e lëvrimin të kredisë dhe i pa-rimbursueshëm në rast tërheqje nga kredia apo mbyllje parakohe të kredisë. Kjo vlerë nese nuk paguhet nga klienti perpara disbursimit do të zbritet si pagesë nga vlera e kredisë që do të lëvrohet.
Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë.	Jo.
Shuma e kostove për përdorimin e një mjeti të caktuar pagese (p.sh. kartë krediti)	Kostot në rast të pagesës së detyrimeve me para në dorë 100 ALL për çdo pagesë të kryer në cash.
Kushtet në të cilat mund të ndryshohen kostot e lartpërmendura në lidhje me marrëveshjen e kredisë.	Kostoja e lartpërmendur në rastin e shlyerjes së detyrimeve në para mund të ndryshohet herë pas here në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Kredise dhe ligjit dhe do të zbatohet në bazë të Tabelës së Interesit dhe Komisioneve në fuqi.
Kostot në rast vonese te pagesave.	Kamatëvonesa: 2 % për çdo ditë vonesë e llogaritur mbi vlerën totale të principalit dhe interesit të papaguar të prapambetur. Shembull i përlllogaritjes së kamatëvonesës: <i>Supozojmë se për një kësht pagese kemi 1,000 ALL Principal + 50 ALL Interes. Në rast se ky kësht nuk paguhet në datën e përcaktuar në grafikun e pagesave, dhe pagesa rezulton me një ditë vonese, kamatëvonesa përlllogarit: 1,050 * 2% = 21 ALL.</i> <i>Në ditën e dytë, kjo kamatëvonesë do të jetë 21 * 2 = 42 ALL, dhe me rritjen e ditëve të vonesës, kamatëvonesa rritet për çdo ditë vonese me vlerën 21 ALL, deri kur arrin maksimumin e saj të lejuar.</i> <i>Në rast se detyrimi kontraktor paguhet pjesërisht si dhe një pjesë e kamatvonesës paguhet, përlllogaritja e kamatvonesës vijon për të ndaluar rritjen e saj përsëri kur vlera e kamatvonesës së papaguar arrin 30% të vlerës së detyrimit të papaguar në vonese.</i>

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

E drejta për t’u tërhequr nga Kontrata e kredise apo Kredia kryesore.	Po. Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kredia pa pasur kosto shtesë brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit duke dërguar një njoftim me shkrim në ECFA Sh.a , duke specifikuar burimin e fondeve të shlyerjes.
Kredimarresi ka të drejtë të tërhiqet nga marrëveshja e kredisë brenda një periudhe prej 14 ditësh kalendarike.	Klienti duhet të shlyejë shumën e principalit brenda të njëjtës periudhë 14-ditore, së bashku me interesin, të llogaritur proporcionalisht në bazë të numrit të ditëve të përdorimit të kredisë (nga data e disbursimit deri në datën e shlyerjes). Nëse institucioni financiar ka ofruar një shërbim ndihmës në lidhje me kontratën e kredisë në bazë të një marrëveshjeje me një palë të tretë, klienti nuk do të ketë më asnjë detyrim sipas kësaj marrëveshjeje me ushtrimin e të drejtës për t’u tërhequr nga kontrata e kredisë.

Mbyllja parakohe Kredimarrësi ka të drejtë të shlyejë kredinë para kohe në çdo kohë plotësisht ose pjesërisht.	Po. Klienti ka të drejtë të shlyejë kredinë plotësisht ose pjesërisht në çdo kohë përpara datës së caktuar, duke paguar interes vetëm për periudhën aktuale të përdorimit të kredisë.
Kosto në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	Në rast mbyllje të plotë parakohe, ECFA Sh.a do të mbajë një komision mbi vlerën e principalit të mbetur prej 0.5 % të shumës së kredisë së mbetur, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon 1 vit, dhe 1 % të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit.
Mundësia e zëvendësimit të sendit / pronës (kolaterali)	E pazbatueshme.
Produkte dhe shërbime të tjera	1) Profili juaj online – Pas cdo aplikimi ju do të pajiseni me disa kredenciale për t'u loguar më pas çdo herë dhe për tu njohur me informacion mbi ecurinë e procesit të kërkesës për kredi si dhe me informacionin mbi kredinë aktive nëse lidhet një marrëveshje kredie mes nesh. Ky shërbim ofrohet pa pagesë. 2) Lëvrimi i kredisë me para në dorë. Zbatohet vetëm kur kredia kërkohet të jepet në para në degët e ECFA Sh.a, Western Union ose EasyPay. ECFA Sh.a merr përsipër të gjitha komisionet e ngarkuara nga bankat e nivelit të dytë kur ju kërkoni që kredia juaj të disbursohet nëpërmjet një transferte bankare në llogarinë tuaj bankare. Tarifa e tërheqjes së parave në shumën (përqindje e tarifës së tërheqjes së parave të gatshme) 14 % mbi shumën e disbursuar. Ky komision llogaritet mbi vlerën e kredisë së disbursuar dhe është i pagueshëm në momentin e disbursimit të kredisë dhe i pakthyeshëm në rast mbylljeje të parakohshme të kredisë ose tërheqje nga kredia. Kjo vlerë nese nuk paguhet nga klienti përpara disbursimit do të zbritet si pagesë nga vlera e kredisë që do të lëvrohet. 3) Shërbim shtesë për dokumente. ECFA Sh.a vë në dispozicion të klientit, sapo të lidhë një marrëveshje kredie, akses në portalin e personalizuar të klientit në faqen zyrtare të internetit, nga ku çdo klient mund të tërheqë në çdo kohë dhe pa limit, kopje të kontratës dhe dokumenteve të tjera të përpunuara gjatë aplikimit për kredi, si dhe konfirmimin e historikut dhe statusit aktual të kredisë me ECFA Sh.a. Në rastet kur, përveç sa më sipër, klienti kërkon një dokument shtesë të printuar dhe të nënshkruar, atëherë do të aplikohet një komision dokumentacioni prej 2000 lekësh, i pagueshëm në momentin e dorëzimit të dokumentit. 4) Shtyrja e datës së pagesës. ECFA Sh.a ju ofron gjithashtu mundësinë e shtyrjes së datës së pagesës me 30 ditë, e cila aktivizohet kur paguhet tarifa e shtyrjes – 35 % mbi detyrimin e mbetur që po shtyhet. Për një kredi me disa këste, mund të përdorni shtyrjen deri në 1 herë për cdo këst. Kujdes! E drejta e përdorimit të shtyrjes së datës së pagesës nuk është e garantuar dhe ofrohet me kritere të përcaktuara në politikat e brendshme të kompanisë. Ju mund të merrni informacione të përditësuara gjatë jetës së kredisë për t'u njohur me mundësitë e shtyrjes, në portalin tuaj personal në faqen tonë të internetit. www.kredo.al/login 5) Ristrukturimi i Kredisë. ECFA Sh.a, u ofron klientëve në vështirësi pagese dhe ndryshimin e gjendjes së tyre financiare, opsionin e ristrukturimit të kredisë, duke mundësuar uljen e vlerës së kësteve duke zgjidhur datën e maturimit për pjesën e mbetur të kredisë. Ristrukturimi është një vendim i brendshëm i institucionit dhe jo një e drejtë e klientit, dhe pas plotësimit të kërkesës me shkrim nga klienti, rishikohen aspektet financiare dhe aftësia e tij e pagesës për të marrë vendimin e duhur. Tarifa e ristrukturimit për një kredi me këste është 5 % mbi shumën e mbetur të kredisë. Çdo ristrukturim kredie raportohet në regjistrin kombëtar të kredive me statusin 2 – në ndjekje.
Informimi në rast refuzimi të kredisë.	Në rast refuzimi të aplikimit tuaj për kredi, refuzimi dhe arsyet e refuzimit do t'ju njoftohen personalisht në degë, me sms në numrin tuaj të telefonit apo me e-mail në rastet kur keni regjistruar një adresë e-maili në kontaktet tuaja.

E drejta e pajisjes me kopjen e Projekt Kontratës së Kredisë.

Kredimarrësi ka të drejtë me kërkesën e tij të pajiset me kopje Projekt-Kontratë Kredie. Kjo e drejtë nuk do të ushtrohet nëse institucioni financiar nuk do të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me Kredimarrësin. ECFA Sh.a ka vendosur në dispozicion në faqen e saj zyrtare tek tabela e Kostove dhe Interesave të Kredise, link përkatës për të aksesuar një projekt kontrate për të gjithë të interesuarit edhe pa filluar një aplikim për kredi

Mënyra e njoftimit të Kredimarrësit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.

Çdo ndryshim në kontratën e kredisë do t'ju njoftohet me e-mail apo sms apo çdo mënyrë tjetër njoftimi të parashikuar në kontratën e kredisë. Klientit do t'i jepet një afat i caktuar për të miratuar apo refuzuar ndryshimet në Kontratë.

Mënyra e ankimit të klientit pranë ECFA Sh.a.

Për çdo problem apo ankesë që ju dëshironi të ndani me ECFA Sh.a, jeni të lutur të kontaktoni në numrin Call Center +355 44 500 600; dhe në adresën info@kredo.al. Ju do të merrni një përgjigje për kërkesën tuaj brenda 24 orëve.

Periudha kohore gjatë së cilës ECFA Sh.a ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.

Ky informacion është i vlefshëm prej datës 11.07.2025 deri në datën 18.07.2025

Konsumatori

(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(Emër Mbiemër, Nënshkrimi)



Ti mund ta shtysh datë pagesën me 30 ditë!



Shtyrja aktivizohet vetëm kur paguhet Tarifa për Shtyrje



Hyr në profilin tënd për t'u informuar mbi Tarifën e Shtyrjes!



Ti mund të përdorësh 1 shtyrje për çdo kësht!